

PAULO COELHO  
**ZAHIRI**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA

*Libra nga Paulo Coelho,*  
*prej Shtëpisë Botuese TOENA*

- ❑ Alkimisti
- ❑ Mali i pestë
- ❑ Veronika vendos të vdesë
- ❑ Djalli dhe zonjusha Pryn
- ❑ Njëmbëdhjetë minuta
- ❑ Pelegrini i Kompostelës
- ❑ Manuali i luftëtarit të dritës

Paulo COELHO

# Zahiri

---

■ *roman* ■

---

*Përktheu:*  
Durim TAÇE

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2006

*Titulli në original*

Paulo Coelho, O Zahir

Ky libër u botua sipas marrëveshjes me

Sant Jordi Asociados Agencia Literaria S.L., Barcelona.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Botuese: Irena Toçi

Redaktor: Fatmir Toçi

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

ISBN 99943 - 1 - 049 - 6

© Paulo Coelho ([www.paulocoelho.com](http://www.paulocoelho.com))

© *Në gjuhën shqipe*: Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: ++355 4 22 40 116; ++355 4 22 58 893

Fax: ++355 4 22 40 117

E-mail: [toena@toena.com.al](mailto:toena@toena.com.al) ; [info@toena.com.al](mailto:info@toena.com.al)

[toena@icc.al.eu.org](mailto:toena@icc.al.eu.org)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

“Kush prej jush që ka njëqind dele dhe humbet njërën, nuk i lë nëntëdhjetë e nëntë të tjerat në shkretëtirë dhe shkon në kërkim të asaj që ka humbur, derisa ta gjejë?”

Luka 15, 4

*Oh, Marie e ngjizur pa mëkatuar,  
lutu për ne që përgjërohemi për Ty,  
Amen!*

Kur të nisesh drejt Itakës,  
udha jote do të jetë e gjatë,  
plot aventura dhe njohje të reja.

Mos ki frikë nga Lestrigonët dhe Ciklopët,  
as nga i tërbuari Poseidon;  
gjatë udhës tënde ti nuk do t'i ndeshësh  
nëse do ta kesh mendjen e ngritur dhe emocioni  
nuk do ta braktisë kurrë trupin dhe shpirtin tënd.  
Lestrigonët e Ciklopët, dhe i tërbuari Poseidon,  
nuk do ta presin rrugën  
nëse ti nuk i sjell me vete në zemër,  
nëse shpirti yt nuk do t'i vërë para shtegut tënd.

Shpresoj të jetë e gjatë udha jote.  
Do të jenë të shumta mëngjeset e verës  
të mbushura me kënaqësinë e papërshkruar  
të zbulimit të porteve të reja.

Kërko të vizitosh pazaret e Fenikisë  
dhe merr aty gjërat më të mira.  
Shko nëpër qytetet e Egjiptit,  
mëso nga një popull që ka ç'të tregojë.

Ti mos e humb nga syri Itakën,  
por ndiqe fatin tënd deri në fund.  
Mos i nxito hapat më kot:  
është mirë që udhëtimi të zgjasë në vite  
dhe anija jote ta hedhë spirancën në ishull  
kur ti ta kesh përvetësuar  
atë që ke njohur gjatë ecjes.  
Mos prit pasuri të tjera nga Itaka!  
Itaka ta ka dhënë tashmë këtë udhëtim të bukur;  
pa Itakën, ti kurrë nuk do të ishe nisur:  
Ajo të fali gjithçka mund të të jepte.

Kur ta gjesh më në fund Itakën të varfër,  
mos mendo se të ka mashtruar,  
sepse je bërë i mençur, ke rrojtur një jetë të vrullshme,  
ky është kuptimi i Itakës.

Kostandinos Kavafis (1863-1933), *Itaka*



## I kushtohet

Në makinë i thashë se i kisha vënë pikën e fundit variantit të parë të librit tim. Kur filluam të ngjithnim një zonë malore të Pirenejve, që e mbanim për të shenjtë, pasi aty kishim kaluar momente të jashtëzakonshme, e pyeta në donte ta dinte se cila ishte tema qendrore, apo titulli. Më tha se do të kishte dashur shumë të më pyeste, por se kishte heshtur për hir të respektit të punës sime dhe se kishte qenë e kënaqur, shumë e kënaqur.

I fola atëherë për titullin dhe temën qendrore. Vazhduam të ecnim në heshtje dhe, duke u kthyer, dëgjuam një zhurmë: era po afrohej. Kalonte mbi majat e zhveshura të pemëve dhe zbriste deri te ne, duke shfaqur edhe një herë magjinë e malësisë, forcën e saj.

Më pas filloi të binte dëborë. Ndalova dhe qëndrova të vështroja atë moment të magjishëm: flokët e dëborës që binin, qielli gri, pylli dhe ajo pranë meje. Ajo që ka qenë gjithmonë përkrah meje, gjatë gjithë kohës.

Pata një dëshirë të fortë t'ia thosha që atë çast, por e lashë që ta zbulonte vetë më vonë kur të shfletonte për herë të parë këto faqe. Këtë libër ta kushtoj ty Kristina, gruaja ime!



“Sipas shkrimtarit Jorge Luis Borges, ideja e Zahirit vjen nga tradita islamike dhe mendohet të jetë shfaqur rreth shekullit XVIII. Zahir, në arabisht do të thotë i dukshëm, i pranishëm, që nuk mund të kalosh pa u vënë re. Diçka ose dikush që, si ka vendosur një kontakt me ne më parë, vjen e pushton dalëngadalë mendimin tonë, deri në atë pikë sa nuk mundemi të përqendrohemi në asgjë tjetër. Dhe kjo mund të konsiderohet si shenjtëri ose si çmenduri.”

Faubourg Saint-Pères, *Enciklopedia e Fantastikes*, 1953.



Unë jam një njeri i lirë



Ajo, Esteri, korrespondente lufte e sapokthyer nga Iraku, pasi pushtimi i vendit mund të ndodhte nga një moment në tjetrin, tridhjetë vjeç, e martuar, pa fëmijë. Ai, një burrë i papërcaktuar, rreth njëzet e tre apo njëzet e katër vjeç, zeshkan, me tipare prej mongoli. Të dy janë parë për herë të fundit në një kafe të rrugës “Faubourg Saint-Honoré”.

Policia është informuar se ata janë takuar dikur, edhe pse askush nuk ishte në gjendje të thoshte se sa herë: Esteri kishte pohuar gjithmonë se burri, të cilit i fshihte identitetin nën emrin Mikhail, ishte një person shumë i rëndësishëm, mirëpo nuk e kishte shpjeguar kurrë përse ishte i rëndësishëm për karrierën e saj të gazetares, apo për të si grua.

Policia hapi zyrtarisht një hetim. U shqyrtuan mundësitë e mbajtjes peng: e kërcënimit, e rrëmbimit, pasuar me vrasjen, për të cilën askush nuk do të ishte habitur, pasi puna e saj e detyronte

të hynte shpesh në kontakt me individë të lidhur me celula terroriste, për të marrë informacione. U zbuluan tërheqje të rregullta parash nga numri i saj i llogarisë, javët e fundit para zhdukjes: hetuesit thanë se ky element lidhej me pagesat e informacioneve. Nuk kishte marrë me vete asnjë nga veshjet e saj; pasaporta e saj nuk u gjet, për çudi.

Ai ishte një i panjohur, shumë i ri, askushi për policinë, që nuk kish lënë asnjë gjurmë që mund të çonte në identifikimin e tij.

Ajo, Esteri, me dy çmime ndërkombëtare për gazetari, tridhjetë vjeç, e martuar.

Gruaja ime.



Më morën brenda, menjëherë, si të dyshuar, pasi nuk pranoja të sqaroja ku kisha qenë ditën e zhdukjes së saj. Por tani roja i burgut sapo ka hapur portën, duke më komunikuar se jam një njeri i lirë.

E përse më liruan? Sepse sot dihet gjithçka për këdo, sapo dëshirohet një informacion, ja ku e ke: ku u përdor karta e kreditit, cilat kanë qenë vendet që kemi frekuentuar, ku kemi fjetur? Në rastin tim, ishte fare e thjeshtë: një grua, edhe ajo gazetare, shoqe e gruas sime, e ndarë nga burri, pra, pa asnjë problem për të thënë se e kishte kaluar natën me mua, kishte ardhur vetë të dëshmonte në favorin tim sa kishte marrë vesh për ndalimin. Kishte dhënë prova materiale që ditën dhe natën e zhdukjes së Esterit, unë kisha qenë me të.

Shkoj të flas me inspektorin përgjegjës që më jep sendet e mia vetjake, kërkon falje dhe më njofton se ndalimi im është bërë në bazë të ligjit, prandaj

nuk mund të padisja apo të citoja shtetin për gjykim. I shpjegova se as që e kisha ndërmend ta bëja: e di, se kushdo prej nesh është i dyshuar dhe nën vëzhgim, gjatë gjithë njëzet e katër orëve, pa kryer asnjë lloj krimi.

“Jeni i lirë”, - tha, duke përsëritur fjalët e rojës së burgut. I them se nuk është e mundur që gruas sime t’i ketë ndodhur me të vërtetë diçka. Esteri kishte thënë se, për shkak të rrjetit të saj të stërmadh të kontakteve me botën e fshehtë të terrorizmit, herë pas here kishte ndjesinë se hapat e saj përgjoheshin nga larg.

Inspektori bën bisht. Unë ngulmoj, por ai nuk më thotë asgjë tjetër.

E pyes pastaj nëse Esteri mund të përdorte pasaportën e vet për të lënë vendin, dhe ai pohon: “Përderisa nuk ka kryer asnjë krim, përse të mos hynte e të dilte kur të donte nga vendi?”

“Pra, ekziston mundësia që ajo të mos gjendet më në Francë?”

“Mendoni se mos gruaja ju ka braktisur për shkak të asaj tjetrës me të cilën ke shkuar në shtrat?”

I them se kjo s’ka ç’i duhet. Inspektori hesht një çast, merr një pamje serioze dhe shpjegon se ndalimi im mund të konsiderohet një procedurë rutinë, ndërsa thotë se është shumë i shqetësuar për

zhdukjen e gruas sime. Edhe ai është i martuar dhe thotë se librat e mi nuk i pëlqejnë - pra e di se kush jam! Nuk është aq i paditur sa duket! E kupton gjendjen në të cilën ndodhem dhe e di se po kaloj një moment të vështirë.

*E pyes se çfarë duhet të bëj tani e tutje. Ai më jep kartëvizitën e tij, duke kërkuar ta njoftoj për çdo të re - është një skenë që e kam parë tashmë nëpër filma: nuk më bind, inspektorët dinë gjithmonë shumë më tepër nga sa thonë.*

Më pyet nëse e kam takuar ndonjëherë njeriun që ndodhej me Esterin dhe kur e kam parë për herë të fundit. I përgjigjem se njihja emrin e tij të koduar, por që nuk e kisha parë kurrë personalisht.

Më pyet edhe nëse kishim ndonjë problem në shtëpi. I them që Esteri dhe unë jemi bashkë që prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe kemi pasur problemet normale të një çifti: as më shumë e as më pak.

Pastaj, me takt, më pyet nëse kemi folur kohët e fundit për divorc ose, mbase, gruaja ime kishte ndërmend të ndahej. I përgjigjem se asnjë hipotezë e tillë nuk është hedhur, edhe pse, si të “gjithë çiftet”, e përsëris, ndonjëherë kemi pasur edhe ndonjë debat.

- Ndonjëherë apo shpesh?

- Ndonjëherë, - përsëris unë.

Në fund më pyet, akoma më i njerëzishëm, nëse Esteri kishte ndonjë dyshim në lidhje me marrëdhënien time me shoqen e saj. I përgjigjem duke i thënë se ajo ka qenë nata e parë dhe e fundit që e kemi kaluar bashkë. Nuk kishte asnjë marrëdhënie: në të vërtetë ishte fjala për një mëkat kalimtar, një mungesë respekti. Ishte një ditë e mërzitshme pasdreke, nuk kisha me se të merresha. Loja e ngacmimeve është gjithmonë diçka që na zgjon në jetë dhe kështu kishim përfunduar në shtrat.

“Ju shkoni në shtrat me dikë vetëm pse dita është e mërzitshme?”

Mendoj t’i përgjigjem se këto lloj pyetjesh nuk kanë të bëjnë me hetimet, por ja që më duhet bashkëpunimi me të, mbase do të kem nevojë për të më vonë: tek e fundit, është gjithmonë i pranishëm një institucion i padukshëm me emrin “Banka e Favoreve”, e cila më ka hyrë gjithmonë në punë.

“Ja që të ndodh nganjëherë. Nuk ke asgjë interesante për të bërë, tjetra është në kërkim të emocioneve të forta, unë të aventurave, dhe ja tek u bë. Të nesërmen bëjmë sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe jeta vazhdon.”

Ai më falënderon, më zgjat dorën, thotë se në botën e tij nuk është tamam kështu. Edhe për të ekziston mërzia, bezdia, madje edhe dëshira për të shkuar në shtrat me dikë, por këto janë gjëra shumë më të kontrolluara, askush nuk bën atë që mendon dhe dëshiron.

“Mbase për artistët gjërat janë më të lehta, më të lirshme”, - komenton.

I përgjigjem që e njoh botën e tij, por që tani nuk dua të hyj në krahasime mes opinioneve tona të ndryshme mbi shoqërinë dhe mbi qeniet njerëzore. Më pas rri në heshtje, duke pritur lëvizjen tjetër të përlogaritur prej tij.

“Epo, mirë, meqë e kemi fjalën te liria, ju jeni i lirë të shkoni!” - thotë inspektori, i zhgënjyer nga fakti që shkrimtari nuk do ta ngasë bisedën me policin. “Tani që ju njoh personalisht, do t’i lexoj librat tuaja: në të vërtetë, thashë se nuk më pëlqenin, por në fakt nuk i kam lexuar ende.”

Nuk është as e para, as e fundit herë që e dëgjoj këtë frazë. Tekefundit, ky episod më shërbeu për të fituar një lexues: e përsëhendes dhe iki.

Jam i lirë. Dola nga burgu, gruaja ime është zhdukur në rrethana misterioze; nuk kam një orar fiks pune, nuk kam asnjë problem në marrëdhëniet

njerëzore, jam i pasur dhe i famshëm, dhe nëse Esteri më ka lënë, shumë shpejt do të gjej një tjetër në vend të saj. Jam i lirë dhe i pavarur.

Po çfarë është liria?

E kam kaluar pjesën më të madhe të jetës sime si skllav i diçkaje, kështu që duhet ta kuptoj shumë mirë domethënien e kësaj fjale. Që fëmijë kam luftuar ta kisha thesarin tim më të çmuar. Kam luftuar kundër prindërve të mi që donin të më bënin inxhinier e jo shkrimtar. Kam luftuar kundër shokëve të mi të shkollës që shumë shpejt do të më zgjidhnin si viktimë për shakatë e tyre perverse dhe vetëm pas shumë gjaku të derdhur nga hundët tona, vetëm pas shumë pasditeve të kaluara duke i fshehur vrajat e zënkave nënës time, sepse isha unë ai që duhej t'i zgjidhja problemet, jo ajo; arrita të dëshmoja se mund t'i duroja ngacmimet dhe grushtet pa qarë. Kam luftuar që të gjeja një punë për të jetuar, kam punuar si arkëtar në një dyqan hekurishtesh që t'i shpëtoja presionit të zakonshëm familjar: “Ne të japim para, vetëm po të bësh si themi ne!”

Kam luftuar, edhe pse pa dobi, për vajzën që doja dhe më donte në adoleshencë. Ajo më la sepse prindërit e saj e bindën që unë nuk kisha të ardhme.

Kam luftuar kundër mjedisit armiqësor të gazetarisë, puna ima e mëvonshme, ku shefi im i parë

më bëri të pres tri orë dhe më kushtoi vëmendje vetëm kur fillova t'ia gris librin që po lexonte: atëherë më pa i habitur dhe e kuptoi që kishte përpara një person të aftë që të ngulmonte dhe ta përballonte “armikun”, dy cilësi këto themelore për një kronist të mirë. Kam luftuar për idealin socialist: përfundova në burg, dola pastaj dhe vazhdova të luftoja, duke u ndier pjesë e klasës punëtore, deri kur dëgjova këngët e Beatles-ve dhe vendosa që ishte më argëtuese të doja rokun sesa Marksini. Kam luftuar të fitoj dashurinë e gruas sime të parë, të dytë dhe të tretë, dhe kam luftuar që të kisha guximin të ndahesha nga e para, nga e dyta dhe nga gruaja ime e tretë, sepse dashuria nuk kishte rezistuar dhe unë, sidoqoftë, duhej të ecja përpara, derisa të gjeja personin që ekzistonte në këtë botë enkas për mua - dhe ajo qenie nuk ishte asnjëra prej tyre.

Kam luftuar që të merrja guximin për të lënë punën në gazetë dhe të zhytesha në aventurën e shkrimit të një libri, duke e ditur mirë që në vendin tim nuk gjendej asnjë për be që të ishte i zoti të rronte nga letërsia. Hoqa dorë brenda vitit, pasi kisha shkruar më shumë se një mijë faqe, që mua më dukeshin gjeniale, edhe pse nuk i kuptoja as vetë.

Ndërsa luftoja, shikoja të tjerët që flisnin në emër të lirisë dhe, sa më shumë mbronin këtë të drejtë absolute, aq më tepër tregoheshin skllëvër të dëshirave të prindërve, të një martese në të cilën premtorin të mbeteshin përkrah bashkëshortes “përjetë”, ose shfaqeshin robër të peshores, të dietave, të projekteve të lëna përgjysmë, të dashurive në të cilat nuk mund të thuhet “Jo” dhe “Mjaft”; të fundjavave në të cilat ishin të shtrënguar të hanin drekë me ata që nuk i dëshironin. Skllëvër të luksit, të pamjes së luksit. Skllëvër të një jete që nuk e kishin zgjedhur, por që ishin të detyruar ta jetonin sepse dikush, tek e fundit, i kishte bindur se ky vegjetim ishte më i miri për ta. Dhe kështu kalonin net dhe ditë, të gjitha njësoj, në të cilat aventura ishte vetëm një fjalë librash apo një imazh i televizorit gjithmonë të ndezur dhe, sa herë që hapej një derë, ata thoshin: “Nuk më intereson, nuk dua”.

E si mund ta dinin në kishin dëshirë apo jo, përderisa nuk kishin guxuar kurrë të provonin? Por ishte e kotë ta shtroje këtë pyetje: në të vërtetë, kishin frikë nga çdo ndryshim që mund të trazonte botën me të cilën ata ishin mësuar.

Inspektori tha se jam i lirë. Jam tani, siç isha edhe në burg, sepse liria ka qenë gjithmonë gjëja që kam dëshiruar dhe respektuar më shumë në këtë



botë. Është e vërtetë se kjo më ka bërë të heq të zitetë e ullirit, të bëj veprime që nuk do t'i kisha bërë kurrë dhe që nuk do t'i bëj në të ardhmen, të kem në trup dhe në shpirt vraja të shumta, madje, edhe të kem plagosur dikë, të cilit në fund i kam kërkuar falje, në një periudhë gjatë së cilës besoja se mund të bëja gjithçka, përveç detyrimit të një personi tjetër që të më ndiqte në marrëzinë time, në mënyrën time të jetesës. Nuk pendohem për momentet kur kam vuajtur, vrajat në trupin tim i mbaj si medalje, se e di se liria e ka një çmim, po aq të lartë sa skllavëria. Dallimi i vetëm është se ai paguhet më kënaqësi dhe me buzëqeshje, edhe kur buzëqeshja është e lagur me lot.

Dal nga komisarati. Është një ditë me kohë të mirë, një e diel me diell që nuk shkon, në fakt, me gjendjen time shpirtërore. Avokati më pret jashtë me fjalë të ngrohta dhe me një tufë lulësh. Më informon se u ka telefonuar të gjitha spitaleve, të gjithë morgëve - kjo gjë bëhet sa herë dikush vonon të kthehet në shtëpi, por nuk e ka gjetur Esterin. Thotë se ka mundur t'ua fshehë gazetarëve se ku mbahesha i ndaluar. Dhe se do të bëjë një bisedë me mua për të përpunuar një strategji ligjore që do të më lejojë të mbrohem nga akuzat e mëtejshme.

Unë e falënderoj për kujdesin. Megjithatë e di se ai nuk ka ndërmend të diskutojë mbi ndonjë strategji, do vetëm të mos më lërë vetëm, sepse nuk e di cili mund të jetë reagimi im. (Dehem e përfundoj sërish në burg? Bëj ndonjë skandal? Tentoj të vras veten?). Unë i përgjigjem se dua të shpejtoj zgjidhjen e disa çështjeve të rëndësishme, dhe që të dy ne e dimë mirë se unë nuk kam asnjë problem me ligjin. Avokati ngulmon, por unë nuk i lë asnjë shteg: përfundimisht, unë jam një njeri i lirë.

I lirë. I lirë që të rri dëshpërimisht vetëm.

Marr një taksì deri në qendër të Parisit, te Harku i Triumfit. Filloj të eci përgjatë Shans-Elizesë, në drejtim të Hotel Bristolit, ku pinim zakonisht një çokollatë të ngrohtë me Esterin, sa herë që njëri prej nesh kthehej nga një udhëtim jashtë. Ishte një lloj rituali i kthimit në shtëpi, një kredhje në dashurinë që na mbante të bashkuar, edhe pse jeta na shtynte gjithmonë nëpër rrugë të ndryshme.

Vazhdoj ecjen. Njerëzit buzëqeshin, fëmijët u gëzohen këtyre pak orëve pranverore në mes të dimrit. Trafiku është i rrjedhshëm, gjithçka duket në rregull, i përkryer, përveç faktit që askush prej këtyre individëve nuk e di, ose bën sikur nuk e di, mbase thjesht nuk i intereson ta dijë që unë sapa kam humbur gruan time. Po a e dinë se sa po vuaj?

Të gjithë duhej të ishin të trishtuar, t'u vinte keq dhe të bashkoheshin me këtë burrë me zemër të gjakosur. Por ata vazhdonin të qeshnin, të harroheshin në jetët e tyre të vogla dhe të mjera, dhe të zgjoheshin vetëm në fundjava.

Çfarë mendimi qesharak: mbase shumë nga njerëzit që ndesh e kanë shpirtin copë dhe unë as që e di përse po vuajnë.

Hyj në një bar për të blerë cigare, aty më përgjigjen në anglisht. Shkoj në një farmaci për të blerë ndonjë mente, se më pëlqejnë, dhe shitësi përsëri më flet në anglisht. (Në të dyja herët e kam formuluar kërkesën time në frëngjisht.) Përpara se të mbërrij në hotel, ndalohej nga dy djem të porsaardhur nga Tuluza: duan të dinë ku ndodhet njëfarë dyqani; kanë pyetur shumë kalimtarë, por askush nuk i ka kuptuar se çfarë thoshin. Çfarë po ndodh? Gjatë njëzet e katër orëve të burgosjes sime, mbase kanë ndryshuar gjuhën e Shans-Elizësë?

Turizmi dhe paratë janë në gjendje të bëjnë mrekulli: si nuk e kam kuptuar më parë? Sepse, siç duket, Esteri dhe unë nuk e kemi pirë më çokollatën e ngrohtë prej kohësh, edhe pse jemi nisur e kthyer shumë herë kohët e fundit. Gjithmonë ka pasur diçka më të rëndësishme. Gjithmonë kemi pasur ndonjë punë që nuk mund ta shtynim. “Po, e

dashur, herën tjetër do të shkojmë ta pimë patjetër çokollatën tonë, kthehu shpejt!... E di, sot kam një intervistë shumë të rëndësishme dhe nuk mund të shoqëroj në aeroport; merr një taksì, po e mbaj celularin ndezur, nëse ke ndonjë gjë urgjente, më telefono, përndryshe, shihemi sonte!”

Telefoni celular. E nxjerr nga xhepi dhe e ndez menjëherë; lëshon tinguj disa herë dhe, pas secilit, zemra ime hidhet pupthi; në ekran lexoj emrat e personave që më kanë kërkuar, por nuk i përgjigjem askujt. Sikur të shfaqej një “anonim”, do të ishte vetëm ajo, pasi numrin e saj e dinë vetëm pak njerëz që nuk e përhapin. Por nuk shfaqet asgjë e tillë, janë të gjithë numra miqsh ose profesionistësh miq të afërm. Duan të dinë se çfarë ka ndodhur, duan të më ndihmojnë (po si?), duan të dinë në kam nevojë për ndonjë gjë.

Telefoni vazhdon të bjerë. A të përgjigjem? A të takoj dikë prej tyre?

Vendos të rri vetëm, derisa ta kuptoj se çfarë po ndodh.

Mbërrij në Bristol: Esteri thoshte gjithmonë që është ndër të paktët hotele të Parisit ku klientët trajtohen si mysafirë dhe jo si të pastrehë në kërkim të një vendi ku të fusin kokën. Më përshëndesin si të isha i një familjeje me ta. Zgjedh një tavolinë

përpara orës së mrekullueshme, dëgjoj pianon, hedh sytë përtej nga kopshti.

Duhet të jem praktik, të studioj alternativat: jeta vazhdon. Nuk jam as i pari, as i fundit burrë i braktisur nga gruaja - po pse të ndodhte në një ditë si kjo me diell, me njerëz të qeshur nëpër rrugë, me fëmijë që këndojnë, me pranverën që shfaq shenjat e para, me diellin që shkëlqen, me shoferët që ndalin e respektojnë këmbësorët para vijave të bardha?

Marr një kartëpicetë: dua t'i largoj këto ide nga truri dhe t'i hedh në letër. Le t'i lë mënjanë ndjenjat dhe të shikoj se çfarë duhet të bëj:

a) Le ta zëmë se është sekuestruar dhe, në këtë çast e ka jetën në rrezik, e unë, burri i saj, shoku i saj i përjetshëm, duhet të bëj bashkë qiell e tokë dhe ta gjej.

Po ajo ka marrë edhe pasaportën. Policia nuk e di, por ajo ka marrë me vete edhe disa objekte personale dhe një portofol me disa figurina shenjtorësh që i merrte me vete vetëm kur nisej jashtë shtetit. Ka tërhequr edhe para në bankë.

Konkluzioni: ishte përgatitur të nisej.

b) Mbase i ka besuar ndonjë premtimi, i cili, në fund, ka rezultuar një kurth.

Përgjigjja: shpesh binte në situata të rrezikshme, kjo ishte pjesë e punës së saj. Por gjithmonë më

njoftonte, pasi unë isha njeriu tek i cili ajo kishte besim të plotë. M'i tregonte vendet e takimeve, njerëzit me të cilët do të hynte në kontakt (edhe pse, për të mos më vënë në rrezik, shpesh përdorte pseudonimin e njeriut me të cilin do të takohej) dhe se çfarë duhej të bëja unë nëse ajo nuk kthehej brenda një kohe të caktuar.

Përfundimi: nuk kishte pasur ndër mend një takim me dikë nga informatorët e saj.

c) Ta zëmë se ka shkuar me një burrë tjetër.

Përgjigjja: këtu nuk ka përgjigje. Mes gjithë hipotezave, është e vetmja që ka një kuptim. Dhe këtë nuk mund ta pranoj: nuk mund të më braktisë kështu pa më dhënë asnjë arsye. Si unë, si Esteri, jemi krenuar gjithmonë për mënyrën si i kemi përballuar bashkë të gjitha vështirësitë e jetës. Kemi vuajtur, por nuk e kemi gënjyer kurrë njeri-tjetrin, edhe pse heshtja për disa aventura jashtëmartesore ishte pjesë e rregullave të lojës. Me siguri ka ndryshuar pasi njohu njëfarë Mikhaili, por, e shpjegon ky fakt fundin e një martese dhjetëvjeçare?

Edhe po të ketë shkuar në shtrat me të, të jetë dashuruar, a nuk do t'i vinte në peshore të gjitha momentet e kaluara bashkë, gjithçka kemi arritur, përpara se t'i shkrepj t'i hynte një aventure pa kthim? Ishte e lirë të udhëtonte ku të kishte qejf, të jetonte e

rrethuar nga burra, ushtarë që nuk shihnin grua me sy kushedi prej sa kohësh, por unë kurrë nuk i kam kërkuar shpjegime dhe ajo nuk më ka thënë asgjë. Ishim të dy të lirë dhe ndiheshim krenarë për këtë.

Po ja që Esteri është zhdukur. Duke lënë disa gjurmë të dukshme vetëm për mua, si të ishte fjala për një mesazh sekret: “Unë po iki”.

Përse?

Po a ia vlen t’i përgjigjesh kësaj pyetjeje?

Jo, pasi në këtë përgjigje fshihet pazotësia ime për të mbajtur pranë gruan që dua. A ia vlen ta kërkoj për ta bindur që të kthehet, t’i përgjerohem, t’i lutem për një mundësi tjetër për martesën tonë?

E gjitha kjo duket qesharake. Më mirë të vuaj si më parë, kur gra të tjera më kanë lënë. Është më mirë që t’u fryj plagëve, siç kam bërë dikur. Për disa kohë do të vazhdoj të mendoj për të, do të shndërrohem në një qenie të përvuajtur, do t’i mërzis të gjithë miqtë duke folur vetëm për largimin e gruas sime, se nuk do të kem për çfarë të flas tjetër. Do të kërkoj të gjej një justifikim për atë që ka ndodhur, do t’i kaloj ditët dhe netët duke sjellë ndër mend çastet e kaluara me të, duke arritur në përfundimin se ajo ka qenë e ashpër me mua, pikërisht me mua që kam provuar gjithmonë të jem i gatshëm për të bërë më të mirën. Do të gjej gra

të tjera. Duke ecur rrugës do të ndesh dikë që do të mund të ishte si ajo. Do të vuaj ditë e natë, natë e ditë. Dhe kjo gjë mund të zgjasë javë, muaj, mbase edhe më shumë se një vit.

Derisa një mëngjes, duke u zgjuar, do ta kuptoj se po mendoj për diçka tjetër dhe do ta marr vesh se më e keqja ka kaluar. Zemra është dërrmuar, por do ta marrë veten dhe do të rifillojë të shquajë bukurinë e jetës. Ka ndodhur edhe më parë dhe do të ndodhë përsëri: për këtë jam i sigurt. Kur ikën dikush, kjo ndodh se do të vijë dikush tjetër - unë do ta gjej sërish dashurinë.

Për një çast, shijoj idenë e gjendjes sime të re: beqar dhe milioner. Mund të shkoj me kë të dua, hapur. Nëpër festa mund të sillem në një mënyrë krejt të ndryshme nga deri tani. Lajmi do të përhapet me shpejtësi dhe shpejt, shumë gra të reja, ose më pak të reja, të pasura, ose jo aq të pasura sa pretendojnë, inteligjente, ose mbase vetëm të edukuara për të thënë atë që mendojnë dhe që unë dua të dëgjoj, do të trokasin në portën time.

Dua t'i mbush mendjen vetes se është shumë bukur të jesh i lirë. I lirë sërish. I gatshëm për të takuar dashurinë e vërtetë të jetës sime: atë që po më pret dhe që nuk do të më bëjë kurrë më të rijetoj këtë gjendje poshtëruese.



Mbaroj çokollatën dhe shikoj orën: e di që është ende herët për të provuar ndjesinë e këndshme të të qenit përsëri midis njerëzve. Për një copë herë u përfshiva nga ideja se Esteri do të hyjë nga ajo derë duke ecur mbi tapetet persiane, do të ulet pranë meje pa thënë asnjë fjalë, do të pijë një cigare, do të shikojë kopshtin dimëror dhe do të më kapë dorën. Kalon gjysmë ore, gjatë së cilës vazhdoj të besoj në këtë histori që sapo e kam shpikur, derisa filloj ta marr vesh se është fjala për një delir tjetër.

Vendos të mos kthehem në shtëpi. Shkoj në recepsion, kërkoj një dhomë, një furçë dhëmbësh, një deodorant. Hoteli është plot, por drejtori e gjen një mënyrë për të përmbushur kërkesën time: dhe ja ku gjendem në një apartament të bukur me pamje nga Kulla Eifel, me tarracë nga duken çatitë e Parisit, dritat që ndizen pak e nga pak, familjet që hanë darkë në këtë të diel. Dhe më kaplon përsëri ajo ndjesia që provova në Shans-Elize: sa më e bukur është ajo që më rrethon, aq më i braktisur ndihem.

Televizor jo. Darkë jo. Ulem në tarracë dhe kaloj në pasqyrë gjithë jetën time. Një i ri që ëndërronte të bëhej një shkrimtar i famshëm dhe që papritur e kupton se realiteti është krejt ndryshe: shkruan në

një gjuhë që nuk e lexon gati askush, në një vend në të cilin thuhet se nuk ka lexues. Familja e shtyn të shkojë në universitet: “Merr një diplomë biri im, çfarëdo qoftë, përndryshe nuk do të jesh askushi në jetë!” Ai rebelohet, brendh nëpër botë gjatë periudhës së hipive, takon një këngëtar, shkruan tekste të disa këngëve, dhe befas fillon të fitojë më shumë para se motra e tij që i kishte dëgjuar prindërit, që ishte bërë inxhinierë kimike.

Shkruaj tekste të tjera - këngëtari ka përherë e më tepër sukses; unë blej disa apartamente, grindem me muzikantin, por tashmë zotëroj një kapital të mjaftueshëm për ta kaluar pa punuar pjesën tjetër të jetës. Martohem për herë të parë me një grua më të madhe në moshë; prej saj mësoj shumë gjëra: të bëj dashuri, të ngas makinën, të flas anglisht, të shkoj vonë në shtrat, por në fund ndahemi, sepse më cilëson si një burrë “të papjekur nga ana emotive, që i shkon pas çdo çupëline me gjoksin vërshues”. Martohem për herë të dytë, për herë të tretë, me gra për të cilat jam i bindur që do të më japin një qëndrueshmëri emotive: ia arrij kësaj, por zbuloj se kjo qëndrueshmëri aq e ëndërruar shoqërohet me një trishtim të thellë.

Dy ndarje të tjera. Sërish i lirë, por kjo është vetëm një ndjesi. Liria nuk është mungesa e

detyrimeve, por aftësia për të zgjedhur dhe për t'u impenjuar në atë që është më e mirë për mua.

Vazhdoj të jem në kërkim të dashurisë, duke vijuar të shkruaj për botën e muzikës. Atëherë e pyes veten se çfarë po bëj? Përgjigjem se jam një shkrimtar. Dhe kur më thonë se njohin vetëm tekstet e këngëve të mia, u them se ato janë një pjesë e punës sime. Kur më kërkojnë falje se pse nuk kanë lexuar asnjë libër timin, u shpjegoj se po punoj për një projekt. Në fakt po gënjej. Nuk më mungojnë paratë, por guximi për të shkruar një libër: megjithatë, ëndrra ime, tanimë është bërë e realizueshme. Por nëse provoja dhe dështoja, nuk e di si do të më shkonte filli: prandaj, më mirë të jetoja me ëndrrën sesa me mundësinë që ta shikoja atë të dështuar.

Një ditë vjen të më intervistojë një gazetare: donte të zbulonte se çfarë ndihet kur e kupton se puna jote njihet në të gjithë vendin, ndërsa askush nuk e di se kush je, përderisa është vetëm këngëtari që bëhet i dukshëm në mjetet e informimit. Ishte e bukur, inteligjente, e heshtur. U pamë sërish në një festë: tensioni i punës ka rënë dhe unë ia dal ta fus në shtrat po atë natë. Unë dashurohem, ajo mendon se ka qenë vetëm një marrëzi. I telefonoj: më thotë gjithmonë se është e zënë. Por sa më shumë

më refuzon, aq më tepër jam i intriguar. Në fund e bind që të kalojmë një fundjavë në shtëpinë time jashtë qytetit (edhe pse tregohesha me gisht si delja e zezë, kjo e kishte një të mirë: isha i vetmi në atë kohë në rrethin tim të miqve që kisha mundur të blija një shtëpi për pushime).

Kaluan tre ditë bashkë duke soditur detin: gatuaj unë për të, ajo më flet për punën e saj dhe në fund bie në dashuri me mua. Kthehemi në qytet, ajo fillon t'i kalojë netët rregullisht në apartamentin tim. Një mëngjes, del më shpejt se zakonisht dhe kthehet me makinën e saj të shkrimit: nga ai çast, pa u thënë asgjë më shumë, pak e nga pak, shtëpia ime bëhet e saj.

Fillojnë po ato zënka që i kisha jetuar me gratë e mëparshme: ato gjithmonë në kërkim të qëndrueshmërisë, të besnikërisë; unë në kërkim të aventurës dhe të panjohurës. Por, këtë herë, marrëdhënia duket e qëndrueshme. Dy vjet më vonë, megjithatë, paska ardhur momenti që Esteri ta dërgojë përsëri në shtëpi makinën e shkrimit dhe gjithçka tjetër ka sjellë prania e saj.

- Mendoj se nuk do të shkoj gjatë.

M - Po ti më do, edhe unë të dua, apo jo?

- Nuk e di. Nëse më pyet në më pëlqen shoqërimi me ty, përgjigjja është "Po". Nëse kërkon të dish a mund të jetoj pa ty, përgjigjja është përsëri "Po".

- Nuk do të doja kurrsesi të kisha lindur burrë; jam mjaft e kënaqur me qenien time si grua. Në fund të fundit, gjithçka prisni ju burrat prej nesh është të gatujmë mirë. Nga ana tjetër, prej burrave pritet gjithçka: që të jenë të zotë të mbajnë një familje, të bëjnë dashuri, të mbrojnë fëmijët, të gjejnë ushqimin, të kenë sukses.

- Nuk e kam këtu fjalën: unë jam krejt i kënaqur me veten. Më pëlqen shoqërimi me ty, por jam i bindur se e gjitha kjo nuk do të funksionojë.

- Të pëlqen shoqërimi me mua, por ti urren të rrish vetëm me vetveten. Je gjithmonë në kërkim të aventurës, për të mos menduar për gjëra të rëndësishme. Jeton duke ndjekur adrenalinen në

venat e tua dhe harron që në to duhet të rrjedhë vetëm gjak, asgjë tjetër.

- Unë nuk po i shmangem gjërave të rëndësishme. Por cila do të ishte gjëja më e rëndësishme, për shembull?

- Të shkruaje një libër.

- Është diçka që mund ta bëj në çdo moment.

- Bëje atëherë! Pastaj, po të duash, ndahemi.

**E** quaj absurd komentit e saj: unë mund ta shkruaj një libër kur të dua. Njoh botues, gazetarë, shumë njerëz që u kam bërë favore. Esteri është vetëm një grua që ka frikë se mos më humbet: po e sajon gjithçka. Prandaj, mjaft, marrëdhënia jonë po merr fund: nuk është kjo që do ta bënte atë të lumtur, por dashuria.

“Po çfarë është dashuria?” - më pyet. Harxhoj më shumë se gjysmë ore për t’ia shpjeguar dhe, në fund, e kuptoj që nuk mbërrij ta përkufizoj saktë.

Prandaj, sugjeron ajo, përderisa unë nuk jam në gjendje ta përcaktoj dashurinë, më mirë të provoj të shkruaj një libër.

I them se midis këtyre dy gjërave nuk ka asnjë lidhje, se do të iki nga shtëpia në çast, se ajo mund të rrijë në apartament sa të dojë: unë do të fle në hotel derisa të gjej një vend për të jetuar. Më thotë se për të nuk ka asnjë problem: mund të shkoj në çast; brenda një muaji apartamenti do të jetë i lirë

- që të nesërmen do të filloj të kërkoj një banesë tjetër. Kështu, unë përgatis valixhet; ajo fillon të lexojë një libër. I them se tanimë është vonë, po iki mëngjesin tjetër. Më këshillon ta bëj menjëherë, sepse ditën tjetër do të ndihem më i dobët, më i pavendosur. E pyes se mbase ka ndërmend të më heqë qafe. Ajo buzëqesh, duke më kujtuar se isha unë ai që doja t'i jepnim fund. Shkojmë të flemë. Të nesërmen, dëshira për t'ia mbathur nuk është më kaq e fortë, kështu që vendos të mendohem edhe ca. Por Esteri thotë se ai nuk mund të quhet argument i mbyllur: ditë si kjo nuk do të përsëriten më, vetëm kur unë të rrezikoj gjithçka mundem për atë që është qëllimi i jetës sime; ajo do të ndihet e lumtur, dhe atëherë, mbase do të më lërë. Vetëm se, në atë rast qëllimi do të shndërrohet menjëherë në veprim dhe ajo do të kapërcejë çdo pengesë që do t'i dilte përpara. E pyes se çfarë donte të thoshte me këto fjalë. "Të gjej një tjetër, të dashurohem!" - përgjigjet ajo.

Del për të shkuar në gazetë; unë vendos ta mendoj edhe një ditë tjetër (përveç teksteve të këngëve, tani po punoj për një shtëpi diskografike), por në të vërtetë ulem përpara makinës së shkrimit. Çohem, lexoj gazetën, u përgjigjem disa letrave të rëndësishme, pastaj, kur kam mbaruar, merrem me



gjëra të tjera, pa rëndësi, mbaj shënime mbi gjëra që duhet t'i bëj shpejt, dëgjoj pak muzikë, bëj një shëtitje nëpër lagje, ndaloj e flas me shitësin e bukës, kthehem në shtëpi: dita ka kaluar dhe unë nuk ia dola të shkruaja asnjë frazë. Mbërrij në përfundimin se e urrej Esterin: se ajo më detyron të bëj gjëra që nuk i dëshiroj.

Kur kthehet nga gazeta, nuk më pyet për asgjë: pohon vetëm që unë nuk paskam mundur të shkruaj. Dhe shton se vështrimi im i sotëm është njësoj si ai i djeshmi.

Do të punoj ditën tjetër. Në mëbrëmje, megjithatë, ulem përsëri në tavolinë, në të cilën ndodhet makina e shkrimit. Lexoj, shikoj televizor, dëgjoj muzikë, kthehem përpara makinës së shkrimit. Dhe kalojnë kështu dy muaj, gjatë të cilëve bëj përafërsisht të tëra me “frazat e para”, pa mundur kurrë ta mbaroj paragrafin.

Gjej çdo justifikim të mundshëm: “Në këtë vend, nuk lexon askush”, “Ende nuk e kam përcaktuar subjektin”, ose “Kam një ide të mrekullueshme, por po kërkoj mënyrën më të mirë për ta zhvilluar. Veç të tjerash, tani jam edhe i zënë me një artikull, ose me një tekst kënge”. Kalojnë edhe dy muaj të tjerë. Pastaj, një ditë, Esteri vjen në shtëpi me një biletë avioni për mua.

“Mjaft”, - thotë. “Mjaft bëre sikur je tmerrësisht i zënë, sikur e ke gjithçka nën kontroll, dhe sikur bota ka nevojë për atë që po bën, por nisu për ca kohë!” Mund të bëhesha edhe drejtori i revistës ku botoja artikujt, mund të emërohesha edhe president i shtëpisë diskografike për të cilën shkruaj tekstet e këngëve ku jam punësuar aktualisht, sepse ata nuk duan që të punoj edhe për sipërmarrjet muzikore konkurruese. Do të mundesha gjithmonë të kthehesha e të bëja sërish atë që po bëj tani. Por ëndrra ime nuk mund të priste më. O duhet ta filloja ta jetoja, ose ta harroja fare.

“Për ku është bileta?”

“Për në Spanjë.”

Thyej disa gota. “Udhëtimet janë shumë të kushtueshme, e unë nuk mund të mungoj tani, kam një karrierë përpara dhe duhet të merrem me të: kështu do të humbas kushedi sa bashkëpunime!” Problemi nuk jam unë, është martesë jonë. Po të doja të shkruaja një libër, askush nuk do të më pengonte ta bëja.

“Ti mundesh, dëshiron, por nuk e bën”, - thotë ajo. “Dhe problemi yt nuk jam unë, por ti vetë, është më mirë të rrih vetëm për ca kohë!”

Më tregon një hartë. Duhet të shkoj në Madrid, ku do të marr një autobus për të mbërritur në

Pirenejtë, në kufi me Francën. Nga aty nis një shtegtim mesjetar: Rrugëtimi i Santiagos. Duhet ta bëj në këmbë. Në fund, do të jetë ajo që do të më presë dhe, pas kësaj do të pranojë gjithçka që do t'i them: që nuk e dua më, që ende nuk kam grumbulluar përvojë sa për të shkruar një vepër letrare, që do ta largoj përgjithmonë nga vetja idenë për t'u bërë një shkrimtar, pasi e gjitha paskësh qenë një ëndërr prej adoleshenti, asgjë më shumë.

Është një halucinacion! Gruaja me të cilën jam që prej dy vitesh të gjatë - një përjetësi e vërtetë për një raport dashurie - vendos për jetën time: do që unë të braktis punën, që të përshkoj në këmbë një vend të tërë! Është kaq delirante e gjitha kjo, sa që vendos ta marr seriozisht. Për net me radhë dehem - edhe ajo dehet bashkë me mua - edhe pse e urrej të pirët. Bëhem agresiv. E akuzoj se ajo ma ka zili pavarësinë time, i them se kjo ide e çmendur i ka shkrepur vetëm pse i kam thënë se do ta lë. Ajo më thotë se gjithçka ka lindur që kur unë shkoja në shkollë dhe ëndërroja të bëhesha shkrimtar. Tani nuk mund ta shtyja më: o duhet të përballoj vetveten, ose do ta kaloj gjithë jetën duke u martuar, ndarë, duke treguar sa e sa dokrra për të shkuarën time dhe duke u vetëbraktisur gjithmonë e më shumë.

Sigurisht, është e pamundur ta pranoj se ajo ka të drejtë, por e di mirë që po thotë të vërtetën. Dhe, sa më shumë e kuptoj, aq më agresiv bëhem. Ajo e pranon furinë time pa protestuar, duke më kujtuar vetëm se dita e udhëtimit po afrohet.

Një mbrëmje, tanimë, fare pranë ditës së caktuar, refuzon të bëjë dashuri. Unë tymos një cigare të tërë, pi dy shishe verë dhe i humb ndjenjat mu në mes të dhomës. Kur zgjohem, e kuptoj se kam mbërritur në fund të pusit: tani vetëm mund të rizgjohem. Pikërisht unë, krenar për guximin tim, tani vërej se sa i ulët jam, sa i plogët dhe meskin ndaj vetë jetës sime. Atë mëngjes e zgjova me një të puthur dhe i thashë se do të bëja atë që më kishte këshilluar.

Kështu nisem, dhe për tridhjetë e tetë ditë përshkoj Rrugëtimin e Santiagos. Me të mbërritur në Kompostela, e kuptoj se udhëtimi im i vërtetë fillon aty. Mendoj të vendosem në Madrid, të mbahem me të ardhurat nga të drejtat e autorit, duke lënë një oqean të tërë që të më ndajë nga trupi i Esterit - edhe pse zyrtarisht vazhdojmë të jemi bashkë, duke folur disi shpesh në telefon. Është mjaft komode të vazhdoj të jem i lidhur, duke e ditur se mund të kthehem kur të dua në krahët e saj dhe, njëkohësisht, të gëzoj pavarësinë më të plotë.

Dashurohem me një studiuese katalane, pastaj me një argjentinase që realizonte stoli, me një këngëtare të re metroje. Vazhdoj të jetoj me të ardhurat nga e drejta e autorit për tekstet: më mjaftojnë për të jetuar mirë, pa pasur nevojë të punoj, duke pasur në dispozicion kohë të lirë për çdo gjë, edhe për... të shkruar një libër.

Por libri mund të presë edhe ditën tjetër. Kryebashkiaku i Madridit ka vendosur që qyteti të jetë një festë e përhershme, ka krijuar një slogan intrigues (“Madridi më shkatërron”), duke nxitur frekuentimin e disa lokaleve në të njëjtën mbrëmje, duke shpikur shprehjen romantike *movida madrileña* - dhe sigurisht unë nuk mund ta lë gjithë këtë; çdo gjë është shumë argëtuese, ditët janë të shkurtra dhe netët të gjata.

Pastaj, një ditë, Esteri më telefonon dhe më thotë se do të vijë të më takojë: sipas saj, duhet ta zgjidhim përfundimisht situatën tonë. Fikson nisjen për javën tjetër, duke më dhënë kohë kështu që të shpik kushedi sa justifikime: “Po nisem për Portugali, por do të kthehem pas një muaji”, - i them biondes që këndonte në metro dhe që tani fle në banesën time duke dalë çdo mbrëmje për të jetuar *movida madrileña*-n. E rregulloj mirë apartamentin, duke fshirë çdo gjurmë të pranisë femërore dhe u them miqve të mi të mos e hapin gojën: po vjen gruaja ime për të kaluar një muaj me mua.

Esteri zbret nga avioni me një prerje flokësh të shëmtuar: nuk njihet fare. Nisemi për një udhëtim në brendësi të Spanjës, shikojmë qyteza, që për një natë thonë shumë, por që, nëse do të kthehesha sot, as që do e mbaja mend ku binin. Marrim pjesë në korrida, në flamenko; sillem si burri më i mirë në botë, sepse dua që të kthehet me idenë që e dua ende. Nuk e di për çfarë arsyeje dua që ajo të ketë këtë përshtypje, mbase, sepse, thellë jam i bindur që ëndrra e Madridit një ditë do të mbarojë.

Protestoj për prerjen e flokëve të saj dhe ajo e ndryshon: bëhet sërish e bukur. Tanimë mungojnë vetëm dhjetë ditë nga mbarimi i pushimeve, dua që të ikë e kënaqur dhe të më lërë sërish vetëm në këtë Madrid që më shkatërron: diskoteka që hapen në dhjetë të mëngjesit, dema, biseda pa mbarim mbi të njëjtat argumente, alkool, gra, sërish dema dhe gra të tjera - dhe absolutisht asnjë orar.

Një të diel, ndërsa shkojmë drejt një bari që mbetet hapur gjatë gjithë natës, Esteri më pyet diçka mbi argumentin e ndaluar: për librin që thosha se po shkruaja. Pi një shishe Jerez, gjuaj me shkelma dyert metalike që më hapen përpara dhe ngacmoj me fjalë kalimtarët; pastaj e pyes përse ka bërë një udhëtim kaq të gjatë, që të ma bëjë jetën skëterrë, të më prishë gjithë harenë time. Ajo nuk thotë asgjë, por që të dy

e kuptojmë që marrëdhënia jonë ka marrë fund. Nata ime është pa ëndrra, dhe të nesërmen, pasi jam ankuar te drejtori i rezidencës ku banoj për telefonin që nuk punon, pasi i thashë pastrueses se nuk i kishte ndërruar çarçafët që prej një jave, pasi bëra një banjo për ta marrë veten nga dehja e një nate më parë, u ula përpara makinës së shkrimit, vetëm për t'i treguar Esterit se po përpiqesha ndershmërisht të punoja.

Dhe befas, ndodh mrekullia: duke parë atë grua para meje, atë grua që sapo ka përgatitur kafënë, që po lexon gazetën, që e dëshmon të gjithë lodhjen e saj dhe dëshpërimin përmes shikimit, atë grua që rri aty e heshtur, që nuk e shfaq gjithmonë ngrohtësinë e saj me gjeste, atë grua që ia ka dalë të më thotë “po”, kur duhet të më thoshte “jo”, që më ka shtrënguar të luftoj për atë që ajo besonte, dhe me të drejtë, se ishte vetë qëllimi i jetës sime, që i është shmangur shoqërimit tim, sepse dashuria e saj për mua ishte më e madhe se dashuria e saj për vetveten, që më ka bërë t’ia nis ëndrrës sime... dhe ndodh mrekullia. Po, duke parë atë grua kaq të re, të qetë, me shikimin më shprehës se çdo fjalë, shumë herë e trembur në thellësi të zemrës, por gjithmonë e guximshme në veprime, e zonja të dashurojë pa u poshtëruar, pa kërkuar leje për

të luftuar për burrin e saj, befas gishtërinjtë e mi filluan të godasin tastet.

Ja fraza e parë. Pastaj e dyta.

Më pas kaloj dy ditë pa ngrënë, fle vetëm pak orë të nevojshme; fjalët duket sikur rrjedhin nga një vend i panjohur, siç më ndodhte për tekstet e këngëve atëherë kur, pas shumë diskutimeve dhe thashethemeve pa kuptim, kolegu im dhe unë e dinim që ajo “gjë” ishte aty, e pranishme, e gatshme dhe po vinte momenti ta hidhnim në letër dhe në pentagram. Këtë herë e di që “gjëja” vjen nga zemra e Esterit, dashuria ime rilind - unë po e shkruaj librin sepse ajo ekziston, sepse i ka kaluar të gjitha momentet e vështira pa u ankuar, pa e parë veten si një viktimë. Dhe kështu filloj të tregoj përvojën time mbi ngjarjen që më ka prekur vërtet, në vitet e fundit: Rrugëtimi i Santiagos.

Dora-dorës e kuptoj që po vërtetohen ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si unë e shoh botën. Për vite me radhë, kisha studiuar dhe praktikuar magjinë, alkiminë, shkencat okulte. Isha i magjepsur nga ideja që një grup njerëzish kishin një pushtet të pafund i cili nuk duhej ndarë kurrsesi me pjesën tjetër të njerëzimit, pasi do të ishte me rrezik që ky potencial i madh të përfundonte në duart e



njerëzve joekspertë. Kisha bërë pjesë në shoqëri sekrete, isha përfshirë në sekte ezoterikë, kisha blerë libra shumë të shtrenjtë jashtë qarkullimit, kisha shpenzuar një kohë të pafund në rituale dhe procesione. Jeta ime nuk ishte tjetër veçse hyrje dhe dalje nga grupe dhe vëllazëri, gjithmonë i eksituar nga ideja që të takoja dikë që të më zbulonte më në fund të fshehtat e botës së padukshme - dhe gjithmonë i zhgënjyer kur, më në fund, zbuloja që pjesa më e madhe e atyre njerëzve, pavarësisht nga qëllimet e mira, kufizohej në ndjekjen dhe pranimin e një dogme apo të një tjetre, shpesh të shndërruar në fanatikë, pikërisht sepse fanatizmi është e vetmja rrugëdalje për dyshimet që nuk pushojnë kurrë së ngacmuari shpirtin e qenies njerëzore.

Në të vërtetë, kisha zbuluar se shumë rituale funksiononin. Por e kisha kuptuar edhe se ata që mbaheshin mjeshtra dhe ruajtës të të fshehtave të jetës, që pohonin se i njihnin teknikat që do t'i kishin dhënë çdo njeriu aftësinë për të mbërritur atë që do të donte, e kishin humbur tashmë çdo lidhje me mësimet e mëparshme. Të përshkosh Rrugëtimin e Santiagos, të hysh në kontakt me njerëz të zakonshëm, të zbulosh që gjithësia flet një gjuhë individuale, një gjuhë të bërë me “shenja”,

me “sinjale”, dhe për ta kuptuar mjafton ta shikosh me mendjen e zbrazur nga lakoret dhe paragjykimet, me gjithçka ndodh përreth nesh... E gjitha kjo më ka bërë të dyshoj nëse do të ishte okultizmi, vërtet e vetmja portë që të çon te këto mistere. Kështu, në librin tim mbi rrugëtimin, filloj të marr në konsideratë edhe mundësi të tjera të rritjes dhe, në dorën e parë, e mbyll me këto fjalë: “Është shumë e rëndësishme të tregosh vëmendje. Mësimet vijnë gjithmonë kur je i gatshëm. Nëse do të jesh i vëmendshëm ndaj sinjaleve, do të mësosh se gjithçka e ke të nevojshme për të hedhur hapin tjetër”.

Qenia njerëzore duhet të përballojë dy probleme të mëdha: i pari, është të dijë se si të fillojë; i dyti, është të dijë kur të ndalet.

Një javë më vonë, filloi të bëj rishikimet e para, të dyta, të treta... Tashmë Madridi nuk më shkatërron më: është koha të kthehem, E ndiej që është mbyllur një cikël dhe kam një nevojë të ngutshme që të çel një tjetër. I them lamtumirë qytetit, po ashtu siç i kam thënë gjithmonë jetës sime: duke menduar që mund të ndërroj mendje dhe një ditë të kthehem.

Kthehem në vendin tim së bashku me Esterin, me sigurinë që mbase ka ardhur momenti që të gjej një punë tjetër, por përderisa nuk ia dal dot, nuk e

shoh, kjo do të thotë që nuk kam nevojë. Vazhdoj të bëj korrigjimet e librit tim. Nuk besoj se një qenie njerëzore normale do të shfaqë ndonjë interes për përvojën e një njeriu që bën një pelegrinazh në Spanjë, një ecje romantike, por të vështirë.

Katër muaj më vonë, kur mbërrij në rishikimin e dhjetë, zbuloj që dorëshkrimi është zhdukur, si Esteri. Kur jam gati të luaj mendsh, ajo kthehet me një letër nga posta: ia ka dërguar të fejuarit të saj të dikurshëm, që tani zotëron një shtëpi të vogël botuese.

Ish-i fejuari e boton librin. Në shtyp nuk shkruhet asnjë fjalë, megjithatë disa e blejnë librin. Ua rekomandojnë të tjerëve që e blejnë dhe u thonë të tjerëve të bëjnë të njëjtën gjë. Gjashtë muaj më vonë, botimi i parë është shitur i gjithi. Një vit më vonë, janë shtypur tre botime dhe unë filloj të fitoj në një mënyrë që kurrë nuk do ta kisha ëndërruar: me letërsi.

Nuk e di për sa kohë do të zgjasë kjo ëndërr, megjithatë vendos ta përcjell çdo çast si të ishte i mbрами. E kuptoj se sukcesi e shpërthen atë portë që e prisja të hapej prej kohësh: tani shtëpi të tjera botuese e kërkojnë librin e ardhshëm.

Por është, sigurisht, e pamundur që të bësh një Rrugëtim të Santiagos çdo vit: po për çfarë të shkruaj atëherë? A do të rifillojë për mua ai

mundimi i vajtjes përpara i makinës së shkrimit kur unë bëj një mijë gjëra: vetëm fraza dhe paragrafë jo? Është e rëndësishme që të ndaj me të tjerët vizionin tim për botën, kur të tregoj për përvojat e jetës sime. Për disa ditë dhe për shumë net sforcohem, ngulmoj, pastaj them se është e pamundur. Një pasdite, rastësisht, lexoj një përrallë shumë të bukur te “Një mijë e një net”: aty është i mbyllur simboli i rrugëtimit tim, diçka që më ndihmon të kuptoj kush jam dhe përse kam vonuar kaq shumë të marr një vendim që më priste prej kohësh. E përdor atë rrëfim si gjurmë për të shkruar historinë e një bariu delesh që ndjek ëndrrën e tij, një thesar i fshehur në piramidat e Egjiptit. Flas për dashurinë që e pret, pikërisht si Esteri që më kishte pritur ndërsa unë vazhdoja të bjerrja jetën time kot.

Tanimë nuk jam më ai individi që ëndërron të bëhet dikushi: unë jam. Jam bariu që përshkon shkretëtirën... Po ku është alkimisti që e ndihmon të vazhdojë ecjen? Kur mbaroj romanin e ri, nuk e kuptoj mirë se çfarë është: duket një përrallë për të rritur, por të rriturit janë më të interesuar për luftëra, për seks, për ngjarje që flasin për pushtetin. Sidoqoftë botuesi e pranon dhe libri botohet. Dhe sërish lexuesit e shtyjnë në klasifikimin e vëllimeve më të shitur.

Tre vjet më vonë, martesë ime shkon për mrekulli e unë bëj atë që dua; del përkthimi i parë, pastaj i dyti dhe suksesi i ngadalhtë, por solid dhe i qëndrueshëm, bën që librat e mi të njihen në çdo kënd të botës.

Vendos të transferohem në Paris: për kafenetë e tij, për shkrimtarët, për jetën e tij kulturore. Por zbuloj që nuk ekziston më asgjë nga e gjitha kjo: kafenetë janë lokale për turistë të mbushur me fotografi personazhesh që i kanë bërë ata të famshëm. Pjesa më e madhe e shkrimtarëve kujdeset më shumë për stilin sesa për përmbajtjen: të gjithë kërkojnë të jenë origjinalë, por në fakt bëhen të mërzitshëm. Janë të mbyllur në botët e tyre. Unë këtu mësoj një shprehje interesante në gjuhën franceze: “Ma dërgo ashensorin”. Pra, unë flas mirë për librin tënd, flit edhe ti mirë për timin, dhe së bashku krijojmë një jetë të re kulturore, një revolucion të mendimit të ri filozofik. Vuajmë sepse askush nuk na kupton, por tek e fundit kështu u ka ndodhur edhe gjenive në të kaluarën: artisti i madh nuk është kuptuar në kohën e tij.

“Më dërgojnë ashensorin”, dhe në fillim kam ndonjë rezultat - njerëzit nuk duan të rrezikojnë duke kritikuar hapur atë që nuk e kuptojnë. Por më pas, befas, fillojnë të kuptojnë se janë mashtruar dhe nuk i besojnë më fjalëve të kritikës.

Pastaj, vjen interneti me gjuhën e tij të thjeshtë dhe ndryshon botën. Në Paris lind një botë paralele: shkrimtarë të rinj mundohen të kuptojnë fjalët dhe shpirtrat e tyre. Unë u bashkohem atyre, nëpër lokale që nuk i njeh askush, pasi as ato, as edhe shkrimtarët që i frekuentojnë nuk janë të famshëm. E përpunoj stilin tim vetëm dhe kuptoj nga një botues atë që duhet mësuar për bashkëpunimin midis njerëzve.

- Çfarë është Banka e Favoreve?

- E di me siguri. Çdo qenie njerëzore e njeh.

- Ndoshta. Megjithatë nuk po e kuptoj ende ku e ke fjalën.

- Ka qenë e shkruar në një libër të një shkrimtari amerikan. Është banka më e fuqishme e botës. Dhe vepron në të gjitha fushat.

- Unë vij nga një vend pa tradita letrare. Nuk mund t'i bëj nder askujt.

- Kjo nuk ka rëndësi. Po të jap një shembull: unë e di që ti je një personazh i destinuar për t'u afirmuar, për të pasur shumë influencë një ditë. E di, sepse një kohë isha si ti: ambicioz, i pavarur, i ndershëm. Tani nuk e kam më energjinë e atëhershme, por dua të të ndihmoj sepse nuk dua dhe nuk mundem të rri pasiv: ëndrra ime nuk është pensioni, por lufta intrigante që përfaqësohet nga jeta, nga pushteti, nga lavdia. Kështu filloj e depozitoj në llogarinë tënde, jo para, por kontakte. Të prezantoj me këtë, apo me

atë person, duke lehtësuar përpjekjet përcaktuese, vetëm të jenë të ndershme. Ti e di që me detyrohesh për diçka, edhe pse unë nuk kërkoj kurrë asgjë.

- Dhe një ditë...

- Pikërisht kështu. Një ditë të kërkoj diçka: ti mund të ma refuzosh, por e di që je në borxh me mua. Nëse do të bësh atë që të kërkoj, unë do të vijoj ndihmën. Të tjerët e dinë që je një person i ndershëm, do të bëjnë derdhje për llogarinë tënde, do të jenë gjithmonë në kontakte, sepse ky mjedis rron për hir të tyre, vetëm për hir të tyre. Një ditë do të kërkojnë edhe ty diçka, ti do t'i dëgjosh dhe do t'ia shpërblesh atij që të ka ndihmuar. Me kalimin e kohës, rrjeti yt do të shtrihet në botë, do të njohësh ata për të cilët ke nevojë dhe influenza jote do të rritet gjithmonë e më tepër...

- Ose mund të mos e bëj atë që më kërkon...

- Sigurisht. Banka e Favoreve është një investim me të cilin rrezikon, si çdo sipërmarrje tjetër. Mund të më refuzosh favorin që të kërkoj, duke menduar se të kam ndihmuar ngaqë ti e meritoje, se ishe më i miri dhe se të gjithë e paskemi detyrë të njohim talentin tënd. Mirë, atëherë, unë do të falënderoj dhe do të kërkoj një tjetër, në llogarinë e të cilit kam bërë derdhje. Por, nga ai moment, pa qenë nevoja të thuhet asgjë, të gjithë do ta marrin vesh



se ti nuk meriton asnjë lloj besimi. Mund të rritesh ende, por jo aq sa do të doje. Në një çast të caktuar, jeta jote do të fillojë të perëndojë: ke arritur në mes, jo në fund, do të jesh gjysmë i kënaqur, gjysmë i trishtë, nuk do të jesh as një njeri i dështuar, as i realizuar. Nuk do të jesh as i ftohtë, as i ngrohtë: do të jesh i “vakët” dhe, siç thotë një evangjelist në një nga librat e tij të shenjtë, gjërat e vakta nuk e ngacmojnë qiellzën.

**K**ështu botuesi bën shumë depozitime, në kontakte, për llogarinë time në Bankën e Favoreve. Unë mësoj, vuaj... Librat e mi përkthehen në Francë dhe, siç është tradita e atij vendi, ai që është i huaj pritët mirë. Jo vetëm kaq, por kur është i huaj, rrezikon suksesin! Dhjetë vjet më vonë, kam një apartament të madh me pamje mbi Senë, jam i dashur për lexuesit dhe i urreyer nga kritika që më ka adhuruar vetëm kur kam shitur njëqind mijë kopjet e para: nga ai moment nuk kam qenë më kurrë një “gjeni i pakuptuar”. Në afatin e caktuar, i kthej derdhjet e bëra dhe tani, shkurt, jam unë që po jap hua, jam unë që po depozitoj kontakte. Ndikimi im rritet. Mësoj të kërkoj dhe të bëj atë që të tjerët më kërkojnë.

Esteri fiton lejen franceze për të punuar si gazetarë. Veç disa mosmarrëveshjeve që janë të pranishme në çdo martesë, unë jam i kënaqur. Për herë të parë e kuptoj se të gjitha dështimet e mia në

dashuritë dhe në martesat e mëparshme nuk kanë të bëjnë me gratë e së shkuarës, por pikërisht me hidhërimin tim. Esteri ka qenë e vetmja që ka kuptuar diçka shumë të thjeshtë: që ta gjeja veten me të, së pari duhet të gjendesha me vetveten. Jemi së bashku që prej tetë vjetësh dhe unë mendoj se ajo është gruaja e jetës sime. Edhe pse, herë pas here, ose më saktë, jo edhe aq rrallë, marrosem pas grave që i ndesh përgjatë rrugës sime, asnjëherë nuk mendoj se mund të ndahem me të. Nuk e pyes kurrë nëse ajo di gjë për marrëdhëniet e mia jashtëmartesore. Esteri nuk e sjell asnjëherë fjalën rreth kësaj çështjeje.

Prandaj u habita shumë kur, duke dalë nga një kinema, më tha se i ka kërkuar gazetës për të cilën punon që të bëjë një reportazh mbi një luftë civile në Afrikë.

- Çfarë do të thuash?

- Që dua të bëhem korrespondente luftime.

- Ti je e çmëndur! Në fakt nuk ke më asnjë nevojë për një impenjim të tillë. Punon në një fushë që të pëlqen. Fiton mirë, edhe pse ato para nuk është se të hyjnë në punë për të jetuar. Në Bankën e Favoreve i ke të gjitha kontaktet e nevojshme. Ke shumë talent dhe kolegët e tu të respektojnë.

- Atëherë, le të themi se kam nevojë të rri vetëm.

- Për shkakun tim?

- I kemi ndërtuar bashkë jetët tona. Unë e dua burrin tim dhe ai më do, edhe pse nuk është nga më besnikët si burrë.

- Është hera e parë që flet për këtë gjë.

- Sepse nuk ka pikë rëndësie për mua. E çfarë është besnikëria? Ndjesia se zotërojmë një trup dhe një shpirt që nuk është i yni? Dhe ti mendon që unë nuk kam shkuar kurrë në shtrat me një burrë tjetër gjithë këto vite që jemi bashkë?

- Nuk më intereson. Nuk dua ta di.
- As unë nuk dua ta di për ty.
- Atëherë, çfarë është kjo meseleja e luftës në një vend të humbur të botës?
- Kam nevojë. Të thashë, që kam nevojë.
- Po çfarë të mungon?
- Jo, nuk më mungon asgjë nga çfarë do të dëshironte një femër.
- Dhe çfarë nuk shkon atëherë në jetën tënde?
- Mbase kjo. Që i kam të gjitha, por që nuk jam e lumtur. Dhe nuk jam e vetmja. Gjatë këtyre viteve kam takuar dhe intervistuar persona të çdo tipi: të pasur, të varfër, me pushtet, të nënshtruar. Në çdo vështrim të tyre kam lexuar trishtimin e thellë. Ky trishtim jo gjithmonë pranohej, por ishte i pranishëm, pavarësisht nga çfarë thoshin ata. Më dëgjon?
- Sigurisht që po të dëgjoj. Po mendoj. Sipas teje, pra, askush nuk është i lumtur?
- Në dukje, disa janë, por mbase vetëm ngaqë nuk e vrasin shumë mendjen për këtë. Të tjerë bëjnë plane: do të kem një burrë, një grua, një shtëpi, dy fëmijë, një vilë jashtë qytetit. Derisa janë të zënë me këto çështje duken dema në kërkim të toreadorit: reagojnë në mënyrë instinktive, shkojnë përpara pa e ditur se ku është shënjestra. Fitojnë

makinën që dëshironin, nganjëherë edhe Ferrarrin aq të ëndërruar, mendojnë që kuptimi i jetës mbyllet këtu dhe nuk e pyesin më veten në janë të lumtur. Por, pavarësisht nga e gjitha kjo, shikimet e tyre zbulojnë një trishtim që as ata vetë nuk e dinë që e kanë thellë në shpirt. Ti je i lumtur?

- Nuk e di.

- Unë nuk mund të them se nuk ka të lumtur. Sidoqoftë e di që ata janë të zënë: duke bërë orë shtesë në punë, duke u marrë me fëmijët, me bashkëshortin, me karrierën, me diplomën, me punët e nesërme, me gjërat që duhen blerë, me atë që duhet të kenë për të mos qenë inferiorë, e të tjera. Shkurt, pak janë ata që më thonë: “Jam i trishtuar”. Pjesa më e madhe pohon: “Jam shumë mirë, kam arritur atë që dëshiroja”. Atëherë, unë pyes: “Çfarë ju bën të lumtur?” Përgjigjja: “Kam gjithçka që një njeri do të ëndërronte: familje, shtëpi, punë, shëndet”. I bëj një pyetje tjetër: “A je ndalur ndonjëherë e t’i bësh pyetjen vetes në është vërtet kjo gjithçka në jetë?” Përgjigjja: “Po, kjo është gjithçka”. Dhe unë ngulmoj: “Atëherë, kuptimi i jetës vjen nga puna, nga familja, nga fëmijët që rriten dhe na lënë, nga gruaja ose nga burri - që do të bëhen më shumë miq sesa partner në dashuri. Por një ditë puna do të mbarojë. Çfarë do të bësh

kur të ndodhë kjo?” Përgjigjja: “Nuk ka përgjigje. Ndërrojnë temë”.

- Në të vërtetë, mund të përgjigjeshin: “Kur fëmijët e mi të rriten, kur burri im ose gruaja ime do të jenë një mik a mikeshë, e jo dashnorë të apasionuar, kur të jem në pension... do të kem kohë të lirë që të bëj atë që gjithmonë e kam ëndërruar: të udhëtoj”.

- Dhe ti atëherë do të pyesje: “Po a the se ishe i lumtur? A po bën atë që do?” Dhe në këtë pikë, po, do të thoshin se janë aq të zënë, sa do të ishte më mirë të ndryshonin temë.

- Nëse ngulmoj, ata e zbulojnë më në fund se ka diçka që u mungon. Pronari i një sipërmarrjeje ende nuk e ka përfunduar projektin e tij të ëndërruar; shtëpiakja do të donte më shumë pavarësi ose më shumë para; i riu i dashuruar ka frikë se e humbet të dashurën; të sapodiplomuarit i bëjnë pyetje vetes në e kanë zgjedhur vetë atë karrierë, apo ka qenë dikush tjetër që ka vendosur për ta; dentisti do të kish dashur të ishte një këngëtar; këngëtari do të donte të bëhej politikan, politikani shkrimtar, shkrimtari do të kish dashur të ishte një katundar, dhe atëherë, kur ndeshesh me dikë që po bën atë që ka zgjedhur, ai person e ka shpirtin e turbulluar. Ende nuk ka gjetur paqe. Meqë ra fjala, më fal, nëse ngulmoj, ti je i lumtur?

- Jo. Edhe pse kam gruan që dua, karrierën që gjithmonë kam ëndërruar, lirinë, për të cilën të gjithë miqtë ma kanë zili, udhëtimet, nderet, njohjet, megjithatë, ka diçka...

- Çfarë?

- Mendoj se, nëse ndalemi, jeta e humbet kuptimin e saj.

- Nuk mund të çlodhesh duke parë Parisin, e ndërsa më kap për dore, më thua: “E kam arritur atë që doja, tani le ta gëzojmë jetën që na ka mbetur”.

- Mund ta shikoj Parisin dhe të mbaj dorën, por nuk jam në gjendje të shqiptoj këto fjalë.

- Do të vija bast që në këtë rrugë ku po ecim, të gjithë po provojnë të njëjtën gjë. Gruaja elegante që sapo ka kaluar i harxhon ditët e saj për të ndaluar kohën, duke kontrolluar peshoren, sepse mendon që dashuria varet prej saj. Shiko atë çiftin me dy fëmijë në anën tjetër të rrugës! Jetojnë momente të një lumturie intensive kur dalin shëtitje me fëmijët, mirëpo nënvetëdija e tyre vazhdon gjithmonë t'i terrorizojë: u shkon mendja se mund të humbasin punën apo mund t'i kapë ndonjë sëmundje, që siguracioni shëndetësor mbase nuk do t'u japë paratë e premtuara, që njëri nga fëmijët, qoftë larg, mund të shtypet nga makina. Dhe ndërsa tentojnë



të largojnë mendjen, kërkojnë edhe një mënyrë që të çlirohen nga tragjeditë dhe të mbrohen nga bota.

- Po ai lypësi në cep të rrugës?

- Për atë nuk e di. Kurrë nuk kam folur me një që kërkon lëmoshë. Është vetë portreti i trishtimit, por sytë e tij, si ato të çdo lypësi, duken sikur fshehin diçka. Aty trishtimi është aq i dukshëm, sa që më duket i pabesueshëm.

- Kush na mbeti tjetër?

- As që e kam idenë. Shfletoj revistat popullore të personazheve të famshëm: të gjithë qeshin, të gjithë janë të kënaqur. Por unë që jam e martuar me një të tillë, e di që nuk është kështu: të gjithë po qeshin, ose po argëtohen në atë moment, në atë fotografi, por natën, apo në mëngjes, është gjithmonë ndryshe. “Çfarë duhet të bëj që të jem i pranishëm nëpër revista?”; “Si mund ta fsheh që nuk i kam më mjetet e nevojshme për të jetuar në luks?”; “A do të jem i aftë të administroj pasurinë time, ta shtoj, ta bëj më të madhe se atë të të tjerëve?”; “Aktorja me të cilën pozoj në këtë fotografi, që tani qesh e festoj me të, nesër mund të më vjedhë skenën!”; “Do të jem e veshur më mirë se ajo?”; “Përse qeshim kur ne urrehemi?”; “Përse u shesim lumturi lexuesve të kësaj reviste kur jemi thellësisht të trishtuar, skllëvër të famës?”

- Ne nuk jemi skllëvër të famës.

- Mjaft u bëre paranoiak, nuk e kam fjalën për ne të dy!

- Çfarë mendon se do të ndodhë?

- Disa vjet më parë, kam lexuar një libër që tregonte një histori interesante. Supozojmë që Hitleri ka fituar luftën, ka shfarosur të gjithë hebrenjtë e botës dhe e ka bindur popullin e tij se ekziston me të vërtetë një racë superiore. Librat e historisë ndryshojnë, dhe njëqind vjet më vonë, ndjekësit e tij arrijnë të shfarosin edhe hidusët. Treqind vjet të tjera dhe zezakët nuk janë më. Do të duhen edhe pesëqind vjet, por në fund, makina e fuqishme gjermane e luftës ia del të fshijë nga faqja e dheut racën e verdhë. Librat e historisë flasin për betejat e shkuara kundër barbarëve: askush nuk i lexon me vëmendje, pasi e gjitha kjo nuk ka më asnjë rëndësi.

- Kështu, dy mijë vjet pas lindjes së nazizmit, në një bar të Tokios - që prej pesë shekujsh banojnë njerëz të gjatë, me sy të kaltër - janë Hansi dhe Frici që po pinë një birra. Në një moment, Hansi shikon Fricin dhe e pyet:

“Fric, ti mendon se gjithmonë ka qenë kështu?”

“Kush ka qenë kështu?” - do të dijë Frici.

“Bota.”

“Sigurisht që bota ka qenë gjithmonë kështu: a nuk na e kanë mësuar kështu?”

“Tamam. Nuk e di përse e bëra këtë pyetje idiote”, - thotë Hansi.

- Mbarojnë birrat e tyre, flasin mbi gjëra të tjera dhe e harrojnë fare atë temë.

- Nuk ka nevojë të shkojmë kaq larg në të ardhmen: mjafton të kthehemi tek e shkuara, të kthemi dy mijë vjet. A do të ishe në gjendje të admiroje një gijotinë, një trekëmbësh, një karrige elektrike?

- E di ku do të dalësh: te mundimi më i madh njerëzor, kryqëzimi. Më kujtohet që kam lexuar te Ciceroni se ai ishte “një ndëshkim i urryer” që shkaktonte vuajtje të tmerrshme përpara se të vinte vdekja. Dhe sot shumë njerëz e mbajnë në qafë, e vënë nëpër faqet e mureve nëpër dhoma... Tanimë e barazojnë me një simbol vetëm fetar: kanë harruar se kanë përpara një instrument torture.

- Duhet shtuar se janë dashur të kalojnë dy shekuj e gjysmë përpara se dikush të vendoste se u duhej dhënë fund festave pagane me rastin e ekuinoksit të dimrit, ditën kur dielli është më larg nga toka. Apostujt dhe ndjekësit e tyre ishin shumë të impenjuar në përhapjen e mesazhit të Jezusit, prandaj nuk e vrisnin kurrë mendjen për *Natalis invicti Solis*, festën e lindjes së diellit që binte më 25 dhjetor. Derisa një peshkop tha se festat e ekuinokseve ishin një kërcënim për fenë - me të thënë e me të bërë! Sot

kemi meshat, betlemet, dhuratat, predikimet, pupacët plastikë në grazhdet prej druri... Dhe bindjen, bindjen absolute se Krishti ka lindur pikërisht atë ditë!

- Kemi edhe pemën e Vitit të Ri. A e di cila është zanafilla e saj?

- As që e kam idenë.

- Shën Bonifaci vendosi të “krishtëronte” një ritual që bëhej për nder të perëndisë Odin kur ishte fëmijë. Një ditë në vit, tributë gjermanike vendosnin dhurata përreth një lisi, duke lënë që fëmijët t’i gjenin. Kështu mendonin se do ta gëzonin këtë perëndi pagane.

- Duke u kthyer te historia e Hansit dhe e Fricit, ti mendon se qytetërimi, raportet njerëzore, dëshirat dhe zotërimet tona... të gjitha këto janë fryt i një historie që nuk është rrëfyer kurrë?

- Edhe ti ke mbërritur në këtë përfundim duke shkruar mbi Rrugëtimin e Santiagos, apo jo? Më parë mendoje se një rreth të zgjedhurish e njihte domethënien e simboleve magjike. Sot je në gjendje të pohosh se këtë domethënie e njohim të gjithë, edhe pse është harruar.

- Ta njohësh nuk shton asgjë: njerëzit përpiqen me të gjitha forcat që të mos kujtojnë, që të mos e pranojnë forcën e pafundme magjike që zotërojnë.

Sepse kjo do të prishte ekuilibrat e universeve të tyre të organizuara më së miri.

- Sidoqoftë, të gjithë i kanë ato aftësi, nuk është kështu?

- Ashtu është. Por u mungon guximi për të ndjekur ëndrrat dhe sinjalet. Vallë, nga këtu zë fill edhe ky trishtim?

- Nuk e di. Dhe nuk po them se jam gjithmonë e trishtuar. Argëtohem, e dua, e adhuroj punën time. Por, herë pas here më kaplon ky trishtim i thellë, nganjëherë i përzier me ndjenjën e fajit apo të frikës. Është një ndjesi që kalon, për t'u kthyer më vonë dhe për të ikur sërish. Si Hansi ynë, unë bëj pyetjen si ishte më parë. Por nuk i jap dot një përgjigje tamam, thjesht harroj. Mund të shkoja për të shpëtuar fëmijë nga uria, të themeloja një shoqatë për mbrojtjen e delfinëve, të filloja të shpëtoja njerëz në emrin e Krishtit, të merresha me diçka që do të më bënte të ndihesha i nevojshëm, por nuk dua.

- Po kjo historia e vajtjes ku ka luftë, çdo të thotë?

- Për mua, në luftë njeriu gjendet në zgrip: mund të vdesë ditën tjetër. Dhe ai që është në buzë të greminës, vepron ndryshe.

- Do që të gjesh një përgjigje për pyetjen e Hansit?

- Po.

Sot, në këtë dhomë luksoze të hotelit “Bristol”, me Kullën Eifel që ndriçon për pesë minuta, sa herë që akrepi i sahatit shënon orën, bën një xhiro të plotë, me një shishe vere të mbyllur dhe me cigaret që po më mbarojnë, me njerëzit rrotull që më përshëndesin sikur të mos kishte ndodhur asgjë e rëndë, unë i bëj pyetje vetes se mos vallë gjithçka ka nisur atë ditë, me të dalë nga kinemaja. Duhet të ndihesha i detyruar ta lija të ikte në kërkim të kësaj historie të famshme të treguar kaq arbitrarisht, apo të tregohesha më i rreptë, t’i thosha që ta hiqte nga mendja, sepse ishte gruaja ime dhe unë kisha nevojë për praninë dhe mbështetjen e saj?

Marrëzira. Atëherë, e dija, sikurse tani, që nuk kisha asnjë mundësi tjetër përveç pranimin të asaj që ajo dëshironte. Nëse do t’i kisha thënë “zgjidh midis meje dhe korrespondentes së luftës”, do të kisha tradhtuar gjithçka që Esteri kishte bërë për mua.